



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova /
Ministry of Foreign Affairs

Samoa njeh pavarësinë e Kosovës!

Në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, sot në orën 19.30 përmes një fax-i ka mbërritur njohja zyrtare e Republikës së Kosovës nga qeveria e shtetit të Samoas. Në notën verbale, dërguar Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Fatmir Sejdiu thuhet: “I nderuari President, I referohem letrës tuaj të datës 17 shkurt 2008 në të cilën e deklaroni Kosovën shtet të pavarur dhe në të cilën zyrtarisht kërkonit njohjen e Republikës së Kosovës si shtet të pavarur.

Dëshiroj të theksoj se Qeveria e shtetit të Samoas ka vendosur t’ a njohë pavarësinë e Kosovës.

Ne shpresojmë se pavarësia e Kosovës do të hasë në njohje edhe më të gjerë, gjë që do të ndihmonte në përmylljen e konfliktit të viteve 90-ta, të cilat e dëmtuan Ballkanin Perëndimor dhe se do të arrijë stabilitet në rajon.

Ju dëshiroj Ju dhe popullit të Kosovës suksese ne përpjekjet tuaja për ndërtimin e shtetit”.

Nota verbale e njohjes zyrtare të Republikës së Kosovës është nënshkruar nga kryeministri I shtetit të pavarur të Samoas, z. Tuilaepa Lupesoliai Sailele Malielegaoi.

Shteti i pavarur i Samoas gjendet në pjesën jugore të Oqeanit Pacifik. Ky vend është pavarësuar nga Zelanda e Re më 1 janar 1962.

Samoa është vendi i 47-të që e ka njohur shtetësinë e Kosovës.